



UNIVERSITETI PUBLIK "KADRI ZEKA" GJILAN

Fakulteti Ekonomik

Adresa: Rr. Zija Shemsiu, p.n., 60000 Gjilan, Republika e Kosovës
www.uni-gjilan.net tel. +383 (0) 280390112

Dekani: Prof.Ass.Dr. Xhevat Sopi

Nr.Ref.05/2085

Datë: 21/10/2019

Bazuar në nenin 73 të Statutit të Përkohshëm të Universitetit Publik të Gjilanit "Kadri Zeka", dhe në bazë të detyrave të përcaktuara nga Mbledhja e parë e Kolegjiut të Dekanëve të UKZ, të mbajtur me datë 14.10.2019, Dekani i Fakultetit Ekonomik te UKZ nxjerr këtë:

VENDIM

Ass.MSc. Nexhat Shkodra, PhDCand., emërohet Koordinator për Cilësi në Fakultetin Ekonomik të Universitetit Publik "Kadri Zeka" Gjilan.

ARSYETIM

Ky emërim vjen si nevojë për një koordinim më të madh mes Fakultetit, Zyrës për Zhvillim Akademik dhe zyrave apo instancave të tjera që merren me cilësinë, mbarëvajtjen e procesit ngritjen e kapaciteteve akademike të stafit etj.,

Po ashtu, në Fakultetin Ekonomik, për aktualitetin e kapaciteteve njerëzore dhe administrative, është më se e nevojshme caktimi i një koordinatori i cili do të kryej detyra në funksion të ngritjes së cilësisë në Fakultetin Ekonomik, e që kanë të bëjnë me: përmbushjen e standardeve më të larta të cilësisë, monitorimin e brendshëm të cilësisë, evaluimit të zhvillimit akademik, e detyra të tjera të kësaj natyre që caktohen nga Dekani.

Përzgjedhja e Ass.MSc. Nexhat Shkodra për këtë pozitë, vjen si rezultat i një performace te shkëlqyeshme qe ai ka treguar gjatë viteve të fundit në punën akademike në FE UKZ, ku ka marrë vlerësime shumë të larta nga studentët.

Nga sa u tha më sipër, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij vendimi, pala mund të parashtroj ankesë në Senatin e Universitetit "Kadri Zeka".

Vendimi t'i dorëzohet:

1. Të përmendurit
2. Rektorit
3. Sekretarit të përgjithshëm
4. Zyrës për Zhvillim Akademik
5. Arkivit të Universitetit

Dekani

Prof.Ass.Dr.Xhevat Sopi